



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 999/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit ISD L.L.C, me seli në Fushë Kosovë, rr. “Shefki Kuleta”, p.nr., kundër debitorit “Higjena” Sh.A., numër unik identifikues 811299082 dhe seli në Deçan, rr. “Bjeshkët e Deçanit”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.B. avokate, me seli në Deçan, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 164/23, i lejuar me datë 15.06.2023, nga Përmbauesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 17.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Higjena” Sh.A., me seli në Deçan, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 164/23, i lejuar me datë 15.06.2023, nga Përmbauesi Privat Eset Murati.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 164/23, i lejuar me datë 15.06.2023, nga Përmbauesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. 001-09-21, e datës 02.09.2021 dhe Faturës nr. 001-04-22, e datës 04.04.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbarimor P.nr. 164/23, të datës 15.06.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 28,101.00, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e rënies në vonesë për secilën faturë vec e vec e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësueses së autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se fatura në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk jepet përshkrimi i shërbimeve që kreditori ka kryer për debitorin, duke mos qenë e qartë se çka kërkohet nga kreditori. Më tej, ka theksuar se gjykata duhet ta ketë të qartë se mbi çfarë pune juridike është bërë faturim, pasi që nga kontrata për shërbime e lidhur ndërmjet Shoqatës për Pastërti dhe Ambient Pamkos dhe NL Higjena sh.a, të autorizuar si autoritet kontraktues nga Komuna e Deçanit dhe të përfaqësuar nga M.B.M. në njërin anë dhe ISD LLC si operator ekonomik për kryerjen e shërbimeve në anën tjetër, bazë për këtë kontratë është Memorandumi i Mirëkuptimit. Ka shtuar se me marrëveshjen e mirëkuptimit është përcaktuar se debitori do të jetë pjesëmarrës në realizimin e projekteve në lartësi prej EUR 3,000.00, ndërsa pjesën tjetër prej EUR 55,000.00 është dashur që Komuna e Deçanit si pjesëmarrëse në këtë kontratë ta deponojnë në llogarinë e NPL Higjena, por që një gjë të tillë nuk e ka bërë. Andaj, duke qenë se shumën prej EUR 3,000.00 debitori e ka përmbushur, për pjesën tjetër të borxhit, i njëjti nuk ka obligim pasi që nuk ka legjitimitet pasiv dhe mungon baza juridike për të kërkuar një gjë të tillë, e që mund ta kërkojë nga Komuna e Deçanit duke u bazuar në marrëveshjen e lartcekur. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, ashtu që urdhrin përmbarimor ta anulojë.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se është lejuar përmbarimi në përputhje me nenin 29 të LPP-së, në bazë të titullit përmbarimor – faturës. Sa i përket pretendimit të debitorit se i njëjti nuk ka legjitimitet pasiv, ka shtuar se me debitorin është lidhur Kontrata për shërbime me shenjë E003-08-21, faturat për shërbimet e kryera i janë dorëzuar debitorit dhe i njëjti nuk ka bërë denoncimin e tyre. Më tej, ka theksuar se pasi që debitori në prapësimin e tij nuk ka ofruar prova me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij, i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton

faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se përmbartuesi privat ka lejuar urdhrin përmbartimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 001-09-21, e datës 02.09.2021 dhe Faturës nr. 001-04-22, e datës 04.04.2022, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar shërbimet të cilat i janë ofruar debitorit, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbartim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet për mungesën e legjitimitetit pasiv të palës në procedurë, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase gjykata në procedurë përmbartimore legjitimitetin e palës e shqyrton duke vlerësuar nëse debitori i emërtuar nga ana e kreditorit në propozim për përmbartim është debitor edhe në dokumentin përmbartimor mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri. Andaj, nisur nga fakti se debitori i emërtuar në propozim për përmbartim rezulton të jetë debitor edhe në faturat mbi të cilat është iniciuar procedura përmbartimore të cilat i ka pranuar duke i nënshkruar dhe vulosur, gjykata vlerëson se debitori “Higjena” Sh.A., ka legjitimitet pasiv në këtë procedurë, përkatësisht se kreditori është i autorizuar që mbi bazën e këtyre dokumenteve të kërkoj përmbushjen nga ana e debitorit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbartimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa

në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 999/23, datë 17.01.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.